



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 30.09.2025
Numër Protokolli: 6472/2025

A.nr.1616/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1616/2025, të datës 21.08.2025, të parashtruar nga ankuesja D.V, kundër organit të punësimit/Komunës së Leposaviqit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.1616/2025, të datës 21.08.2025, të parashtruar nga ankuesja D.V.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, D.V (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), ka parashtruar ankesë me datë 21.08.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokolli 5640/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.1616/2025, kundër procedurës së rekrutimit me Nr. Reference RN00017851 *Grup i Administrimit të Përgjithshëm* për pozitën “*Asistent Administrativ*” klasa profesionale 3 numri i kërkuar 3 në Komunën e Leposaviqit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5640/2025, të datës 21.08.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Rezultatet e vlerësimit përfundimtar me numër 13-202/25 të datës 29.07.2025; Dokumentin e identifikimit të ankueses; Emalin e datës 21.0.2025; Kërkesën për përgjigje në ankese të datës 09.09.2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankese të datës 15.09.2025; Konkursin e datës 15.05.2025 për pozitën e punës “*Asistent Administrativ*”; Aplikacionin e datës 16/05/2025 së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur të ankueses D.V;

Aplikacionin e datës 06.06.2025 se bashku me dokumentacionin e bashkangjitur te kandidatit E.I'; Aplikacionin e datës 16.05.2025 të kandidates F.Rr se bashku me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e datës 15.05.2025 të kandidates E.J se bashku me dokumentacionin e bashkangjitur; Listën e aplikantëve me numër te referencës RN00017851; Njoftimin me Nr.147/2025 të datës 23.06.2025 te Njesisë se Burimeve Njerëzore lidhur me kandidatet që i plotësojnë kushtet sipas kriterëve të konkursit; Vendimin me numër 2417 te datës 30.06.2025 për themelimin e komisionit për vlerësimin profesional te kandidateve për pozitën e punës “Asistent Administrativ”; Aktin emërimit të datës 11.09.2020 të anëtarit te komisionit F.B; Aktin e emërimit 13.04.2020 të anëtarit te komisionit A.Sh; Aktin e emërimit të datës 01.09.2021 të anëtarit te komisionit H.V; Aktin e emërimit te datës 01.09.2021 te anëtarit te komisionit E.B; Aktin e emërimit të datës 01.01.2012 të anëtarit te komisionit A.C; Kërkesën me numër 2237 të datës 14.05.2025 për fillimin e procedurave te rekrutimit për pozitën e lira; Njoftimin e datës 04.07.2025 për testim të Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 10.09.2025 te Burimeve Njerëzore të lidhur me mbajtjen e intervistës me goje; Formularët e Vlerësimit Individual te Antareve te Komisionit për ankuesen D.V; Rezultatet e vlerësimit përfundimtar të datës 29.07.2025; Testi individual i kandidates D.V.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë plotësuar parakushtet ligjore që të **përfundoj procedimi administrativ** i filluar me ankesën e ankueses, **sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Leposaviqit datë 14.05.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference RN00017851, për Grupi i administrimit të përgjithshëm për pozitën “*Asistent Administrativ*” në Komunën e Leposaviqit, me afat aplikimi prej datës 15.05.2025 deri më 13.06.2025., ndërsa nga shkresat e lëndës arrihet në konstatimin se edhe ankuesja ka aplikuar në këtë konkurs.

Tutje, nga shkresat e lëndës arrihet në konstatimin se konkursi në fjalë ka përfunduar me datë 29.07.2025 sipas Njoftimit për rezultatet përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm të shpallur nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të Komunës së Leposaviqit, ndërsa ankuesja ankesën në Këshill e ka parashtruar me datë 21.08.2025, kundër procedurës së rekrutimit përkatëse, me pretendimet ankimore se komisioni i pranimit gjate testit me shkrim ka favorizuar disa kandidat duke ju ndihmuar në përgjigje.

Mirëpo, ankuesja me datë 22.09.2025, ka përcjellë parashtresë, përmes e-mailit zyrtar (ankesa.kpmshck@rks-gov.nbet) përmes së cilës deklarohet se e njëjta është tërhequr nga ankesa e saj e parashtruar me datë 21.08.2025 kundër konkursit me numër Reference RN00017851, për pozitën e punës *Grup i Administrimit të Përgjithshëm* për pozitën “*Asistent Administrativ*” të shpallur nga Komuna e Leposaviqit, duke deklaruar se me vullnetin e saj e tërheq ankesën pasi qe nuk ka interes për vazhdimin e saj, ndërsa parashtesa e së njëjtës e datës 22.09.2025 në Këshill është protokolluar me numër: 6252/2025.

Nisur nga rrethanat e paraqitura si më lartë, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “1. *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë; 2. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohet, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë*” dhe erdhi në përfundimin se ankuesja përmes parashtresës së datës 22.09.2025 me numër protokolli:6252/2025 është tërhequr nga ankesa e saj e datës 21.08.2025 e parashtruar në Këshill, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se janë plotësuar parakushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ si në dispozitivin e këtij vendimi, lidhur me ankesën e ankueses A.nr.1616/2025 të datës 21.08.2025.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nënit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1616/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses D.V;
- Komunës së Leposaviqit (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.